



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE TË FORMIMIT
PROFESIONAL**

Nr. 891 Prot

Tiranë, më 24.03.2020

URDHËR

Nr. 9, datë 27.03.2020

**PËR DOKUMENTIMIN E SHËRBIMIT ARSIMOR NË KUSHTET E
EMERGJENCËS SË TË MËSUARIT NË KUSHTET E SHTËPISË**

Referuar Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar, VKM-të nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, VKM-së nr. 554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Udhëzimit nr.11, datë 03.03.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe të veprimtarinë e ofruesve publikë të arimit dhe të formimit profesional” të Ministrisë së Financave të Ekonomisë, Udhëzimit të MASR datë 09.03.2020, për “Mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID -19, Udhëzimit të MASR datë 21.03.2020, “Për Realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, AKPA ka përgjegjësi dhe detyrë që të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit dhe të organizojë punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional, veçanërisht në kushtet e emergjencës, pra të mangësisë së kushteve optimale për realizimin e procesit mësimor, në distancë.

Për të përmbushur me cilësi detyrën e saj ligjore dhe për të marrë vendime të mirëmenduara, AKPA duhet të informohet rregullisht nga ofruesit e AFP. Për shkak se raportimet paraprake që kemi pasur deri tani kanë qenë të ndryshme në strukturë dhe në shkallën e detajimit ato nuk mund ofrojnë të njëjtin informacion për ecurinë dhe cilësinë e zbatimit të udhëzuesit për mësimin në kushtet e shtëpisë, AKPA është e interesuar të garantojë që asnjë veprimtari të mos mbetet e padokumentuar dhe e raportuar, sikurse asnjë nxënësi të mos i cënohet puna studimore dhe, ajo që ka shumë rëndësi, vlerësimi i arritjeve të tyre, si kushte të domosdoshme për përfundimin e vitit shkollor në vijim dhe për zbatimin e kriterit të ndershmërisë dhe të objektivitetit në vlerësimin e tij, të shpallura në Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.

AKPA ndjen përgjegjësinë që procesi në fjalë të kryhet në cilësinë maksimale të mundshme në kushtet e mangësive të ndryshme me të cilat përballen shkollat ose nxënës të veçantë, veçanërisht me ato që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe të ofrojnë, në çdo rast, ndihmën e mundshme për zgjidhjen e problemeve që lidhen me administrimin e këtij shërbimi.

Për sa më lart:

URDHËROJ:

1. Të gjitha shkollat profesionale të kryejnë raportimin sipas një strukture të unifikuar, që ka në bazë vetë strukturën e planifikimit të veprimtarive që shkollat e kanë bërë sipas udhëzimit të MASR dhe të përgjegjësive për kryerjen e tyre. Themelore në këtë raportim do të jetë realizimi i dokumentimit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Në këtë kuadër, puna e sekretarisë së shkollës, në bashkëpunim me mësuesit dhe drejtorinë për të printuar dhe ruajtur në dosje të veçanta këto dokumente bëhet parësore. Për vlerësimin, të mbahet parasysh edhe Udhëzimi i MASR, datë 21.03.2020, "Për Realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë";
2. Drejtorët e shkollave të organizojnë punën duke përcaktuar:
 - Përgjegjësitë për secilin punonjës të stafit
 - Drejtor, zv/drejtor, sekretari, psikolog, financa
 - Përgjegjësitë e mësuesit të lëndës dhe mësuesit kujdestar
 - Strukturën e raportimit të brendshëm sipas hierarkisë dhe përgjegjësive
 - Stafi mësimor dhe ndihmës (personeli higjeno-sanitar, magazina etj.) → zv/drejtori → drejtori
 - Kalendarin e veprimtarive mësimore që përmban:
 - Emrin e mësuesit, lëndën, klasën, temën, metodologjinë dhe orën e zhvillimit të mësimin si dhe numrin e nxënësve frekuentues.
3. Në mënyrë të veçantë të gjitha shkollat, përmes mësuesve lëndorë dhe atyre kujdestarë:
 - të mbajnë shënim të gjithë nxënësit që kanë marrë pjesë në të mësuarit online

- të mundësojnë testimin e tyre në bazë të udhëzimit të MASR të përmendur më sipër.
 - të regjistrojnë në dokumentet përkatëse (regjistër) rezultatet e nxënësve (notat);
4. Duke u bazuar në këtë planifikim, drejtorët do të monitorojnë të gjithë procesin dhe do të raportojnë prane KPA-s deri më dt. 03.04.2020, në lidhje me çfarë kanë zhvilluar dhe po zhvillojnë për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID -19, **sipas modeleve bashkëlidhur këtij urdhëri.**
5. Përveç modelit shifror të raportimit, shkollat do të hartojnë edhe një raport narrativ, në të cilin do të përshkruajnë:
- ecurinë e procesit
 - problemet/sfidat/sugjerimet kryesore
 - në lidhje me zhvillimin e veprimtarive praktike
 - në lidhje me vlerësimin e nxënësve
 - të tjera.
6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen të gjitha shkollave profesionale (34 shkolla)

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Elira DEMIRAJ

Punuan: Klarita Dautaj
 Pranoi: Etleva, Gjelaç
 Nr.kopj: ____ (____)
 Date: 26.03.2020

